



## DETYRË PROJEKTIMI

**PËR REALIZIMIN E STUDIM -PROJEKTIMIT:**

**“RIKONSTRUKSION I RRUGËS TOPOJAN”**

MIRATOI:

ZV/ KRYETARI

Granit GJANA



Kukës, Gusht 2023



## 1.1 Informacion i përgjithshëm

### Vendodhja

Topojani është një nga komunat më veri-lindore të Republikës së Shqipërisë në koordinatat gjeografike  $41^{\circ} 59' 30''$  në veri dhe  $20^{\circ} 31' 18''$  në Jug. Topojani ka një reliev të thyer kodrinor-malor, me male të larta të veshura, pllaja, bjeshkë dhe livadhe. Në lindje kufizohet me komunën Shishtavec, me fshatrat Kollovoz, Shtreze, Novosej, në jug kufizohet me komunën Grykë-Çajë dhe fshatin Buzmadhe, në perëndim ngrihet madhështor Mali i Gjalicës deri në Tërshenë, ndërsa në pjesën veriore kufizohet me komunën Zapod me fshatrat Oreshk, Orcikel. Komuna Topojan i përket një zone të pasur ujore me shumë burime, të cilat në një reliev kryesisht të thyer formojnë dhe Lumin e Topojanit, siç njihet nga vendasit (Reka e Topojanit).

### Klima dhe hidrologjia

Në Topojan dallohen dy lloje klimash: klima submalore (në zonën e vendbanimeve), në viset e ulëta dhe klima malore alpine në pjesët e larta malore. Në përgjithësi kjo klimë karakterizohet me verë relativisht të freskët dhe të shkurtër dhe më dimër të gjatë dhe të ftohtë. Topojani ka rrjet lumor relativisht të dendur. Komuna Topojan i përket një zone të pasur ujore me shumë burime, të cilat në një reliev kryesisht të thyer formojnë dhe Lumin e Topojanit, siç njihet nga vendasit (Reka e Topojanit). Ky lum ndan përgjysmë grykën shkëmbore të Vanave. Lumi krijohet nga bashkimi i dy degeve kryesore, reka e Shtrezes me burim nga bjeshket e Kallabakut dhe degës kryesore me burim nga Bjeshket e Okxherit e deri ne Krue te Kuq.

## **Demografia dhe përfituesit**

Njësia administrative e Topojanit është e përbërë nga pesë fshatra me një popullsi prej 2.607 banorë, kjo sipas statistikave dhe regjistrit të vitit 2014, sot numërohet një numër më i vogël banorësh si efekt i migrimit në zona të mëdha të urbanizuara të Republikës së Shqipërisë, kryesisht në Tiranë, Durrës, Kavajë etj. Më shumë se gjysma e popullsisë (63% e popullatës së përgjithshme) është e vendosur në dy fshatrat BREKIJE (33% e popullsisë totale) dhe Topojan (30% e popullatës së përgjithshme). 16% e popullsisë së komunës Topojan i zë mosha nga (31 deri në 45 vjeç) është pjesa më aktive e popullsisë, ndërsa 25% e popullsisë e zë mosha nga (16 deri 30 vjet) që përkufizohet si fuqi punëtore. Një tjetër fakt i rëndësishëm është se 42% e popullsisë përfaqëson popullsinë më të re (0-15 vjeç), të cilat mund të konsiderohen si potencial dhe pasuri në të ardhmen e Topojanasve. Banorët e fshatit Topojan (30% e popullatës së përgjithshme) janë përfituesit kryesorë dhe më të mëdhenj të investimit të kësaj rruge. Gjithashtu nuk mund të lëmë pa përmendur edhe turistët e shumtë që po shtohen dita-ditës për të vizituar zonën.

### **1.2 Qëllimi dhe objektivi i investimit**

#### **1.2.1 Qëllimi i investimit**

Qëllimi i investimit është përmirësimi i infrastrukturës rrugore në këtë zonë e cila do ketë impakt të drejteperdrejtë në jëtën e banorëve dhe në turizmin malor. Investimi i këtij objekti ka për qëllim ta shndërrojë rrugën në një hapësirë më të sigurt duke përmirësuar transportin dhe cilësisë së jetës së banorëve dhe përdoruesve të rrugës.

Arsyet për investim janë të shumta po ndër to mund të përmendim:

- Rritet siguria në rrugë.
- Rritet cilësia e lëvizjes dhe transportit.
- Zvogëlon kohën e levizjes në gjatësinë e kësaj rruge.
- Përmirësim i jetesës së banorëve.
- Nxiti turizmin malor duke nxitur kështu dhe përmisimin e ekonomisë së zonës.

#### **1.2.2 Objektivi i Investimit**

Objektivi i detyrës së projektimit është hartimi i projektit të plotë të këtij objekti. Për realizimin e projektit, projektuesit duhet të rishikojnë të gjithë informacionin ekzistues që disponon Bashkia Kukës dhe të mirëstudijë gjendjen ekzistuese. Projektuesit duhet të konsultohen me të dhënat dhe strategjitë e zhvillimit të Bashkisë Kukës, dhe institucione të tjera. Cilësia e studim-projektimit duhet të jetë e tillë që të arrihet standarti i kërkuar dhe të plotësojë kushtet teknike të projektimit të veprave të tilla.



### 1.2.3 Problematikat dhe gjendja ekzistuese e rrugës

Traseja e rrugës ka gjerësi 3 – 3.5m në disa vende dhe është në gjendje natyrore. Për shkak të kushteve të relievit dhe ndikimit të faktorëve atmosferikë rruga është e amortizuar. Gjithashtu ndikimi i përrrenjve të ndryshëm shpesh herë e bën këtë rrugë të vështirë për tu përdorur. Investimi në shtrimin e kësaj rruge me shtresat e nevojshme sipas standarteve, rikonstruksioni dhe vendosja e veprave të artit aty ku është e nevojshme për shkak të intervenimit të rrugës me kanale dhe përrrenj, do e përmirësojnë cilësinë e jetës së banorëve të zonës. Gjithashtu është i domosdoshëm investimi në ndërtimin e saj pasi do të ketë një impakt në zhvillimin e turizmit malor në këtë zonë.

Kërkesa të vecanta

#### a) Infrastruktura rrugore

Rruga të trajtohet sipas gjerësisë të trupit të rrugës të përcaktuar me një karrexhate me një korsi 3.5 m, me bankina nga 50 cm në ane të rrugës.

Shtresat rrugore dhe të bankinave të trajtohen të tilla që të sigurojnë garanci, qëndrueshmëri dhe të përballojnë kapacitetet faktike dhe të prespektivës. Gjithashtu në pika të veçanta, aty ku është e nevojshme, pas studimeve nga projektuesi duhet të shihet mundësia e mureve mbajtëse, veprave të artit. Aty ku është e nevojshme do të vendosen “guardrail” për shkak të terrenit. Materialet që do të përdoren, të jenë sipas kushteve teknike të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve. Materiali kryesor ndërtimor për disiplinimin e ujerave do të jetë përdorimi i tubacioneve prej betoni (tombinove prej betoni). Diametri i tombinave të jetë në varësi të prurjeve dhe madhësisë së përrrenjeve.

Kërkohej që projektuesi të konsultohet vazhdimisht me Bashkinë Kukës përpara fillimit të punës për projektin, ashtu si edhe gjatë të gjitha fazave të projektimit dhe zbatimit të tij. Kjo si për garantimin e saktësisë së bazës së të dhënave, ashtu edhe për reflektimin e ndryshimeve të pritshme nga plan/studimet e përmendura më sipër.

Përveç saktësisë së të dhënave si më sipër, projektuesi përpara se të fillojë punën me projektimin duhet që paraprakisht:

1. Të bëjë rilevimin e zonës duke evidentuar të gjithë elementët e dallueshëm topografikë, elementët e rrjeteve të propozuara të infrastrukturës.
2. Të bëjë të gjitha azhornimet e rrjetit të infrastrukturës
3. Projektuesi duhet të bëjë verifikimin paraprak në terren dhe sondime për saktësinë e të dhënave/azhornimeve, për rrjetin e infrastrukturës, përpara fillimit të projektimit. Kjo duhet në mënyrë që të evitohen pasaktësitë gjatë projektimit dhe zbatimit, si rezultat i të dhënave të marra që nuk përputhen me gjendjen në terren;
4. Të bëjë studimet përkatëse gjeologjike, hidrologjike etj.

## **Rrjetit rrugor**

Projektuesi duhet të paraqesë mënyrat e aksesit, të qarkullimit në rrugë dhe lidhjet me rrjetin ekzistues rrugor të zonës.

## **Sinjalistika**

Sinjalistika do të përfshijë sinjalistikën vertikale dhe horizontale. Vijëzimi në rrugë konsiston në aplikimin e vijëzimeve rrugore në sipërfaqen e asfaltuar dhe të pastruar paraprakisht nga papastërtitë dhe pluhurat, në përputhje me vendndodhjen dhe dimensionet e paraqitura në vizatim ose nën drejtimin e inxhinjerit të ngarkuar. Për sinjalistikën horizontale do të përdoret bojë bikomponente. Në asnjë rast sinjalistika horizontale nuk duhet të jetë në kontraktë me atë vertikale. Sinjalet vertikale do të jenë tabela me forma të ndryshme sipas nevojës. Keto tabela vendosen vertikalisht në anë të rrugës ose mbi të.

## **Hartimi i Preventivit**

Në hartimin e preventivit, çmimet e përdorura duhet të jenë sipas manualit teknik në fuqi dhe llogaritja e preventivit do të bëhet sipas normave dhe akteve ligjore në fuqi për të siguruar kursimin dhe efikasitetin e përdorimit të fondeve. Nëse preventivi ka analiza projektuesi duhet të paraqesë dhe analizat teknike për secilin zë punimesh të cilët nuk përfshihen në manual.

## **STANDARTET**

### **-Standarte në Projektim**

Projekti do të hartohet në përputhje me të gjitha normat dhe standartet për projektim që parashikon legjislacioni në fuqi. Projektimi duhet të sigurojë respektimin e standarteve, madje edhe atyre gjatë zbatimit. Është përgjegjësi e Projektuesit saktësia dhe respektimi i të gjitha standarteve dhe normave përkatëse.

Projektuesi mund të rekomandojë edhe prezantimin e standardeve të reja, për përafrimin me normat e BE-se, si dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare në projektim dhe zbatim. Rekomandimet duhet të përmbajnë elemente të fizibilitetit dhe realizueshmërisë me praktikën shqiptare dhe imitimet për financimin e veprës.

### **-Standarte në paraqitjen e dokumentacionit teknik**

Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, Projektuesi të përdorë programet e kërkuara kompjuterike, si dhe të nxitet përdorimi i programeve të reja, me të avancuara të fushës. Në hartimin, paraqitjen dhe miratimin e dokumentacionit teknik të projektit të merren parasysh dhe të respektohen të gjitha kërkesat dokumentare dhe të paraqitjes që parashikon Ligji “Për urbanistikën”, Rregullorja e Urbanistikës dhe Legjislacioni në fuqi.

## **Realizimi i Projektit**

Fazat e projektimit për këtë objekt sipas VKM nr. 354 datë 11.05.2016 janë:

- Analiza e Detyrës së Projektimit/Terma Reference dhe përcaktimi bazës së projektit
- Projekt Idea Paraprake



- Projekti i Zbatimit
- Preventivi Përfundimtar

### **Projekt Zbatimi**

Të kryhet hartimi i Projekt “Rikonstruksion i rrugës TopoJan” i cili duhet të përmbajë:

1. Dokumentat që vërtetojnë të drejtat pasurure të pronës/ave që marrin pjesë në një zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronareve dhe zhvilluesit ose palëve të treta:
2. Raportin Teknik Hartimi i relievit topografik të rrugës (kordinata lokale, kuota absolute)
3. Plani i Vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin hartës në gjendjen ekzistuese
4. Projekti i ndërtimit në formatin PDF të nënshkruar elektronikisht në format A3 për profilat dhe A2 për planimetritë.
  - a. Planimetri e rrugës në Shk. 1:500 ose 1:1000, Profilat gjatesor Shk. 1:1000, 1:100 dhe Profilat Terthor
  - b. Profila tip dhe detaje të rrugës.
  - c. Hollësi dhe detaje per çdo veper arti dhe mure mbajtëse qe parashikohen
  - d. Planin e sinjalistikës vertikale dhe horizontale bashkë me detajet e nevojshme
  - e. Projektin e zbatimit të rrjetit të kanalizimeve të largimit të ujrave të shiut.
5. Relacionin teknik për projektin në formatin Pdf të nënshkruar elektronikisht
6. Raportin e studimit gjeologjik
7. Raportin e studimit sizmologjik
8. Plan organizimim e punimeve.
9. Raportin e vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)
10. Specifikimet Teknike për zërat e punimeve që do të kryhen.
11. Grafikun e punimeve
12. Preventivin përfundimtar bashke me analizat perkatese
13. Licensë të firmës projektuese, licensë të ekspertit tmjedisor dhe ekstrakt i regjistrit tregtarë.
14. Kopje e policës së sigurimit të projektuesëve, dhe deklaratat e projektuesve të liçensuar për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

*Materialet dorëzohen në 5 kopje format hard copy (të printuar) dhe 5 cd (4 cd në format soft copy cad, excel, word etj, dhe 1 cd në format pdf)*

*Gjithashtu do dorëzohet versioni i dixhitalizuar i cili transferohet në GIS.*

### **Relacioni teknik që shoqëron projektin duhet të përmbajë:**

- Raportin teknik, ku përveç llogaritjeve të sipërpërmendura, do të jepen llogaritjet e shtresave, Të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen ekzistuese, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, raporti gjeologjik, siguria e kalimit në rrugë dhe masat që duhet të merren për rregullimin e trafikut gjatë punimeve të ndërtimit,
- Specifikimet Teknike për ç'do zë pune.
- Metoda e llogaritjes së shtresave të jetë e bazuar në CBR.

**Kostoja e investimit e parashikuar paraprakisht eshte 80'000'000 lekë pa Tvsh:**

Kosto totale do të përgatitet bazuar në projektin e zbatimit, specifikimet teknike, duke marrë parasysh edhe kërkesa të veçanta të Bashkisë Kukës në lidhje me standartet e pranuar dhe për çmimet për njësi sipas manualit teknik të çmimeve V.K.M Nr. 629 Dt.05.11.2015  
Bazuar në vizitat e bëra në terren është konstatuar që i gjithe segmenti është i gjate me nje gjatësi L=1500 m.

**Parakushtet dhe rreziqet në zbatimin e projektit; veprimet e planifikuara për eliminimin e efektit të tyre**

Projekti do të zbatohet në përputhje standartet dhe kushtet teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve në ndërtim.

**Përmbledhje e mënyrës dhe rolit të institucioneve që do të menaxhojnë projektin**

Projekti do të menaxhohet nga drejtoritë dhe sektoret përgjegjëse të Bashkisë Kukës.

**Rekomandime për projektuesin**

Projekti do të hartohet në bashkëpunim të ngushtë me specialistët e Bashkisë.

Projektuesi duhet të përdorë dhe të konsultojë të gjithë informacionin dhe rekomandimet nga studime të ndryshme dhe PPV.

Projektuesi duhet të përdorë studimet dhe të dhënat paraprake që disponohen nga Bashkia.

Projektuesi të bazohet në normat dhe standartet e Kodit Rrugor të Shqipërisë dhe Manuali i Projektimit të Rrugëve.

Të përcaktohet, saktë dhe me përshkrim, rruga sipas klasifikimit, gjerësia e korsive, distancat e shikueshmërisë, limiti i shpejtësisë, zonat ku lejohet ose jo parakalimi, sinjalistika vertikale dhe horizontale e nevojshme, vend-pushimet, etj.

Planifikimi i kanalizimeve dhe drenazhimit të rrugëve me kapacitete të mjaftueshme si një nevojë primare për mbrojtjen e strukturës rrugore.

Punoi: Ark. Andrit SHEHU

Ark. Erta PALUSHI

Ing. Deshira BOGDANI